



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**

Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca / Office of the Chief State Prosecutor

A.nr. 161/2021

Datë: 27/05/2021

Prishtinë;

Kryeprokurori i Shtetit, në pajtim me nenin 1 paragrafi 1 dhe pika 1.1, 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit nr.05/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit me qëllim të zbatimit të ligjshmërisë, ngritjes së efikasitetit dhe zbatimit unik të praktikave dhe legjislacionit për trajtimin e kallëzimeve penale dhe parashtresave të ushtruara ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve nxjerrë këtë;

UDHËZIM

Për trajtimin e Kallëzimeve Penale dhe Parashtresave ndaj Prokurorëve dhe Gjyqtarëve

1. Kallëzimet penale apo parashtresat e ushtruara kundër prokurorëve apo gjyqtarëve duhet të trajtohen në kuadër të prokurorive përkatëse në bazë të kompetencës lëndore dhe territoriale.
2. Në rast të paraqitjes së nevojës që prokurori i rastit të ketë konsultime rreth mënyrës së zgjidhjes së rastit konkret të cilin është duke e trajtuar, prokurori i rastit fillimisht duhet të konsultohet me Kryeprokurorin e asaj prokurorie, e nëse edhe pas këtij konsultimi nuk mund të merret ndonjë vendim, atëherë prokurori i rastit mund të konsultohet, përkatësisht të kërkoj udhëzime prej prokurorit nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, i cili është i caktuar për prokurorinë përkatëse sipas vendimit të Kryeprokurorit të Shtetit A.nr.276/2018 të datës 17 korrik 2018.
3. Në rast të ndonjë kërkesë eventuale prej ndonjërit nga kryeprokurorët e prokurorive themelore dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, e cila kërkesë do t'i referohej delegimit të rastit penal në kompetencë territoriale e lëndore të ndonjë prokurorie tjetër e që ka për subjekt prokurorin apo gjyqtarin, udhëzoheni që në të ardhmen t'i drejtoheni Kryeprokurorit të Shtetit që në kuptim të nenit 1. i cili i referohet nenit 11. par 2. të Ligjit nr. 05/L-034, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit NR.03/L-225 për prokurorin e shtetit të vendosë se cila prokurori do të ri-caktohet me kompetencë për të proceduar atë çështje penale.

Arsyetimi

Bazuar në ligjin bazik për prokurorin e shtetit NR.03/L-225, nenit.3 që i referohet pavarësisë dhe paanshmërisë së prokurorit të shtetit, duke pasur parasysh faktin se prokurori i shtetit është institucion i pavarur që ushtron funksionet e veta në mënyrë të paanshme, konsideroj se për vlerësimin dhe shqyrtimin e rasteve penale si për të gjitha rastet penale ashtu edhe për rastet penale, ku subjekt i tyre janë prokurorët apo gjyqtarët e Republikës së Kosovës me kompetencë të plotë për të vepruar është prokurori i shtetit i asaj prokurorie referuese i cili është i ngarkuar me rast të tillë.

Në rastet kur trajtimi i çështjeve të këtilla ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve nga ana e prokurorive sipas kompetencës lëndore dhe territoriale ku gjenden ata prokuror apo gjyqtar, kur konsiderohet se mund të sjellë deri të cenimi i parimit të paanshmërisë gjatë trajtimit të asaj çështje penale, dhe pas kërkesës së Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse, me qëllim të zhvillimit sa më efikas dhe të pandikuar të procedurës penale në situata të këtilla Kryeprokurori i Shtetit do të marr vendim që të ri-caktoj atë çështje penale në ndonjë prokurori tjetër, krejt këtë të bazuar në nenin 1. i cili i referohet nenit 11. par 2. të Ligjit nr. 05/L-034, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-225 për prokurorin e shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga Kryeprokurori i Shtetit.

Ky udhëzim e shfuqizon udhëzimin e mëparshëm A.nr.508/2015 të datës 02 dhjetor të vitit 2015, si dhe udhëzimin A.nr.511/2015 të datës 06 dhjetor 2015.

Mos respektimi i këtij udhëzimi mund të konsiderohet si shkelje të Kodit të Etikës për kryeprokurorë dhe prokurorë.



Udhëzimi i dërgohet;

- Kryeprokurorëve të prokurorive themelore dhe të gjithë prokurorëve të shtetit;
- Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit dhe Prokurorisë Speciale;
- Arkivit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH).

Obligohet administrata e ZKPSH-së që këtë udhëzim ta publikoj në ueb faqen e Prokurorit të Shtetit.